



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.767, datë 20.10.2025

Kamenicë

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.(03/L-040) për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4, nenit 19 pika 1.19, të Statutit të Komunës së Kamenicës 01 nr.20203 dt 21.06.2023, nenit 14 paragrafi 1.1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve shifra 01 nr. 31251 të dates 29.092023, Drejtoria e Arsimit, shpallë:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë:

- Studentët e rregullt të regjistruar në Universitetin "Kadri Zeka" (UKZ) për vitin akademik 2025/2026;
- Studentët e rregullt nga viti i dytë (II) e tutje, të regjistruar në universitetet publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studimet pasuniversitare (master dhe doktoratë);
- Studentët që nuk janë përsëritës të vitit akademik;
- Studentët që janë banorë të Komunës së Kamenicës.

Kriteret e veçanta

1. Vërtetimi ose ID kartela (kopje) si dëshmi për regjistrimin në UKZ, në vitin e parë të studimeve 2025/2026

1.1. Për vitin e parë të studimeve akademike, do të marrin bursë nxënësit të cilët marrin lëvdatë gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm dhe të gjithë studentët që regjistrohen e rangohen në 10 vendet e para.

2. Nota mesatare

- | | |
|---|---------|
| 2.1. Nota mesatare 9 deri 10 | 30 pikë |
| 2.2. Nota mesatare 8 deri 9 | 20 pikë |
| 2.3. Nota mesatare 7 deri 8 | 15 pikë |
| 2.4. Nota mesatare 6 deri 7 | 10 pikë |
| 3. Numri i studentëve në familje (2 e më shumë) | 10 pikë |
| 4. Kategoritë e dala nga lufta | 10 pikë |

- | | |
|--|---------|
| 5. Student në asistencë sociale | 10 pikë |
| 6. Student në fushat ku ka mungesë të kuadrove | 10 pikë |
| (Mjekësi e përgjithëshme, TIK, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Ndërtimtari, Arkitekturë, Mekanikë, FIEK) | |
| 7. Student me nevoja të veçanta | 10 pikë |
| 8. Student pa dy prindër | 20 pikë |
| 9. Student pa njërin prind | 10 pikë |

Vëmendje: Kriteret sipas pikës (3) – për studentët e së njëjtës familje – vlerësohen vetëm për një student, dhe vetëm nëse dëshmohet me dokumentacion zyrtar se të gjithë studentët e asaj familjeje i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Aplikacioni (formulari zyrtar i Komunës së Kamenicës);
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi original për regjistrimin në vitin akademik 2025/2026;
4. Kopja e dokumentit të identifikimit
5. Certifikata origjinale e notave;
6. Certifikata e vendbanimit;
7. Vërtetimi si anëtar i ngushtë i familjes së kategorive të dala nga lufta;
8. Vërtetimi për shfrytëzim të ndihmës sociale, lëshuar nga Qendra për Punë Sociale;
9. Certifikata e vdekjes për studentët pa njërin ose pa dy prindërit;
10. Vendimi ose vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për studentët me nevoja të veçanta.
11. Konfirmimin bankar.

Vërejtje: Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar ose të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i dokumenteve

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në objektin e Komunës së Kamenicës, rruga "Skënderbeu", brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të këtij konkursi:

- në tabelën e shpalljeve të Komunës,
- në mediat e shkruara, dhe
- në web-faqen zyrtare: <http://kk.rks-gov.net/kamenice>

Shënim

Lartësia e bursës do të përcaktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe numri i aplikuesve që i plotësojnë kushtet për përfitim.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Arim Dervishi

